

Truket (Mastrimet)

në premtimet parazgjedhore



Edukimi i votuesve për vlerësimin e programeve të partive politike


Mashtrimet gjatë premtimeve parazgjedhore

Maqedonia qe gjashtë vite që nuk ka dale nga fushata parazgjedhore. Pyetja është se kur është më e dobët, e kur më intensive. Kjo fushatë filloi qysh nga mesi I vitit të kaluar, intensifikohet në tetor, nxehtet në dhjetor, ndizet në janar, komplikohet ne shkurt... Kryesisht Maqedonia parazgjedhjeve shpirtërisht është e goposur njësoj si rrugët e saja.

Partitë politike përdorin një sistem të përpunuar mahnitës për vetëreklamim, satanizim të kundërshtarit, arsyetim për atë që nuk e kanë realizuar, u imponojnë të tjerëve për atë që se kanë bërë vet, inicojnë hareshë për një send, ndërsa freskojnë mendime për diçka tjetër. Ajo është një industri e tërë mashtrimesh, gjysmë mashtrimesh, maskimi i së vërtetës, manipulim me numrat, por ajo është vetëm ana e publike e përrallës. Fshehtazi, ato kanë sisteme tjera për të detyruar, nënçmuar, korruptuar, premtime personale etj. Arsenali për marketing politik dhe parazgjedhor. Qytetari mundet të provoj që mos ti ndëgjojë, por sa është ajo e mundshme dhe sa ajo do të kishte qenë përgjegjësi për ardhmërinë e tij?

Për atë shkak ky publikim ka për qëllim ti njoftojë qytetarët e rajonit të Palagonisë me truket dhe veprimet, që I bëjnë partitë politike për ti fituar votat. Ajo matematikë partiake nuk nënkupton respektimin e ligjeve dhe personalitetin e qytetarit, por vetëm operacion për grumbullimin.

Edhe vota jote numërohet në këtë matematikë!!!



Për çka mund të shërbej ky publikim!

Grupi projektues i AGTIS-it shumë u mundua te gjej mënyrë për ti afroju truket parazgjedhore, të cilët partitë politike i përdorin për të arritur deri tek vota juaj. Pastaj ne i analizuam të gjithë aktet planifikuese të cilat ekzistojnë në komunat e pelagonisë, që të shohim se a bazohen ofertat e partive politike në ndonjë strategji paraprake për zhvillim, plani hapësinor i Maqedonisë, por edhe analizat e tregut të punës, pasuri të patundshme, subjekte afariste.. ose ato janë vlerësimet më të thjeshta të partive për atë "që kalon tek popullata".

Kishim për qëllim edhe ti krahasojmë ofertat konkrete të kandidatëve për prefekt por ajo nuk është e mundshme, për shkak se programet e tyre janë mahnitshëm të gjata, madje edhe ne rrethinat fshatare për së tepërmi i tejkalojnë kornizat e arsyeshme të programeve partiake për zgjedhjet lokale (edhe opozita e pranoj këtë stil, edhe ato kanë programe të gjata).

Kjo e pamundëson detyrën për analizë serioze të ofertave në çdo komunë - veçanërisht edhe për atë shkak vendosëm këtë publikim tua përkushtojmë këtë edukim qytetarëve për mashtrimet e partive në programet zgjedhore. Me atë, qytetarët do të dinë më mirë të dallojnë premtim mashtrues dhe ti dallojnë nga proektet, të cilat e bartin shtetin përpara.


OriCIP -
329:[342.8:352(497.7)*2013*(036).

ISBN 978-9989-2192-4-5

1. []

COBISS.MK-ID 93470730

, NUB " . " : , 2013. :



Sa larg mund të shkojnë partitë?

Mahnitshëm larg, përkatësisht: s'ka kufij të poshtme! Përveç për pushtet ato nuk kujdesen për asgjë. Ato mund të shkojnë në vijën luftë qytetare, përplasjet ndëretnike, kvazi – mbledhje qytetaresh, një send të shohësh në TV, ndërsa ato të tregojnë se çfarë sheh. Veçanërisht e rrezikshme të përdoren institucionet shtetërore në këtë matematikë. Ajo bëhet “në katror”. Mos u mashtroni!

Dhënie llogarie!

Vetëreklamimi dhe propaganda partiake kryqëzohet si “dhënie llogari deri tek qytetarët”, mos disiplina financiare dhe keqpërdorimi si “kujdesi për grupet e rrezikuara sociale”, arbitrariteti dhe anarkia si “dëshira e qytetarëve”, harxhimi i paqëllimshëm të parave si “përmirësim i standardit të qytetarëve”.

Dialogu

Atë nuk e ka nga viti 2006 dhe ai është mashtrim i madh!!! Kjo është “Maqedonia paralele”, e cila është si dimension i I pestë në hapësirë, diçka që shtetin edhe tani e kushton shumë dhe për çka çmimi do të jetë shumë më i shtrenjtë (jo vetëm me para). Edhe pse larg nga e idealja, le të mos harrojmë se çfarë ishin mediat më parë!

Njëherë kandidat, njëherë prefekt

Me fillimin e fushatës parazgjedhore kandidatët nuk guxojnë të paraqiten në TV dhe në publik si prefektë dhe të presin shirita, të ngrenë gurrë themele, të aktojnë gjoja bëjnë “vepra të mira”. Për atë kanë pas katër vite. Por tek në kjo nuk vlen dhe televizionet partiake lajmet i rikthejnë në spote propaganduese.



Reklamata e shtrenjtë me shtesa të lira

Ndihma e njëhershme është kthyer në lojë e keqe propaganduese në të cilën të varfërit janë statista, kandidati është bamirësia, ndërsa atë që e jep është 100 herë më e vogël se honorari, të cilën statistët do ta kishin fituar, nëse duhet tu paguhet honorari, për pjesëmarrjen në spotin e kandidatit.

Njëherë qeveri, njëherë vetëqeverisje lokale

Qeveria është shumë aktive në fushatën lokale dhe punon për çdo kandidat të saj, sikur nuk është qeveri, por administrata lokale. Kështu, ajo bënë rritjen e pensioneve, jep me dorë dhe kapuç, ndërton nëpër komunat, hedh gur themele. Këto zgjedhje janë më të turpshme dhe më të ulëta në këtë drejtim.



"Më lejoni t'ju them diçka për komunën tuaj..."

Pasi atë tua tregojë liderët e partive flasin për njëri-tjetrin, dhe asgjë për komunën. Ne jemi më se të sigurt se do të ketë zgjedhje të parakohshme parlamentare, e cila është e qartë nga fjalimet e Kryeministrit dhe liderit të opozitës. Fjalimet e tyre janë për zgjedhje parlamentare e jo për zgjedhje lokale. Kjo është qesharake, por në këto zgjedhje do të dëgjojmë për Brankon dhe Nikollën, dhe jo për komunat tona.

"Investimi ynë i huaj"

Edhe një shembull tjetër për të cilin nuk ka investime të huaja janë spotet e partive, në të cilën firmat e huaja të biznesit që kanë investuar në Maqedoni (dhe nuk janë tërhequr shumë me investimet e tyre), janë përdorur si reklamat e qeverisë dhe kandidatit të pozitës. Kjo zgjon dyshimin se këto "investime" janë me të vërtetë të huaja (ndoshta kanë marrë para nga ndonjë parti për të investuar në vend, kështu që tani të fshijnë rrugët me markat e tyre).

Mungesa e iniciativës nga ana e qytetarëve

Gjithmonë partit, por edhe analistët thonë se qytetarët nuk përdorin format e demokracisë së drejtpërdrejtë, siq janë zyrat e para të kryetarëve të komunave, ditë info, "Pyesni kryetarin" se qytetarët presin një tjetër të shkoj në komunë dhe tua zgjidh problemet e tyre.

Ky është një mashtrim! Detyrim është i komunës dhe politikës të shkaktojë pjesëmarrje e vërtetë të qytetarëve. Nëse qytetarët nuk vijnë në takime të tilla, medoemos të ketë shkak për atë. Qytetarët kërkohen kur është gjithçka e kryer dhe e sjellur, për t'i inçizuar në TV ("publikim në masë").

OJQ punojnë pa angazhimin ata nuk duan të qortohen me politikën, kështu që pothuajse të gjitha aktivitetet e tyre janë të butë dhe të padobishme. Nder për përjashtimet.

Partia jonë është në kontakt me popullin

Vitin e kaluar, VMRO - DPMNE shpalli konkurs për kandidat për kryetarë të komunave (dhe ka 55 kryetarë të komunave të saj), me të cilët dëshiron të mbuloj faktin se vetëm kryesia e ngushtë e kësaj partie do të vendosë kush do të jenë kandidatët. Pastaj vijnë përpara me propagandë: "ju propozojnë - ne realizojmë." LSDM-ja nuk pret asnjë sekondë, dhe deklaroi se ata ishin "afër popullit", dhe prej kur ajo - nuk dihet. Partitë janë fortë të demantuara për veprimet e tyre, dhe u pa se ata nuk e kanë studiuar çdo kandidatë për kryetarë komune (i lënë të njejtit), ndërsa në programet e tyre nuk kanë asnjë dëshirë të qytetarëve, por vetëm kurthe për vota.

Shoqatat e qytetarëve dhe "shoqatat qytetare"


Shoqatat kanë edhe mandat qytetarësh dhe e logjikshme është të japin mendimet e tyre për gjendjen dhe ndodhitë në shtetin dhe komunat. Më kryesore është pyetja për shfaqjen e tyre publike: Për cilën e bëjnë atë, a i shprehin mendimet e tyre autentike, a e bëjnë atë me komandën e mbuluesve të tyre?

Nëse dikush organizon takim publik, e cila është e ashtuquajtur jopartiake, ajo mund të zbulohet nga ajo se kush është oratori, ai i përkrahin mediumet që janë nën kontrollin e pushtetit, a do të paraqiten persona politik, dhe sipas përmbajtjes së mbledhjes.

Kategori e veçantë janë mbledhjet të cilat i organizojnë shoqatat e vjetra me specialitet dhe antarësi të kategorizuar (mjek, avokat, ndërmarrës, komiteti i hellsingut për të drejtat e njeriut, transparent Maqedonia, organizata e harxhuesve...).

Më tej, askush nuk donë të priset me pushtetin. Nëse atë e bënë, sipas definicionit duhet më tepër tu besohet, se sa atyre që e mbrojnë pushtetin, për shkak se shumë më sigurt është ta mbrosh pushtetin dhe ta sulmosh opozitën (pushtetit demokratik nuk i nevojitet që dikush ta mbroj, për shkak se ajo i ka institucionet dhe përkrahësit tradicional). Shumë rëndë është tu besohet organizatave, të cilat kanë lidhje të afërta me partitë, të cilët deklarohen si "shkencore", "eksperte", ndërsa s'kanë as të paktën ekzistim 10 vjeçar.

Kriterium kryesor është kujtesa: ai i cili edhe ka sulmuar edhe është mbrojtur nga pushteti i caktuar, është më tepër për tu besuar, ndërsa më tepër duhet të besohen organizatat më të vjetra, të cilat me parti të caktuar kanë qenë edhe në anë të ndryshme edhe në anë të njëjta.



Truket e partive në fushatat zgjedhore

Kujdesuni për numrat

Mashtrim (truk) i ri është asfaltimi i ndonjë vendi të matet me metër katror e jo me gjatësinë e rrugës së asfaltuar. N.q.s gjatësia e rrugës së asfaltuar është e shkurtër, atëherë llogarisin m², e n.q.s rruga është e gjatë dhe e ngushtë atëherë tregojnë për gjatësinë e rrugës së asfaltuar. Shpesh herë buxhetet për projekte janë plotësisht joreale. Trend është për megaprojektet të shkruhen buxhete të cilat janë shumë nën koston reale (nxemje qendrore në komplet qytetet, qendra transportuese me hotele, qendra tregtare, vendbanim me nxemje qendrore...). Projektet reale për të cilët me të vërtet llogarisin partitë, janë shtrenjtë të parashikuara.

Në programet kanë projekte për rekonstruktimin e rrjetit të ujësjellësit me ndërrim të gypave prej asbesti, ku është e para pame shuma, sipas të cilës 1m kanalizim do të kushton vetëm 1200 den. Ajo nuk është e mjaftueshme as për ti nxjerrë gypat e jo për ti ndërruar.

E njëjta, ndërtimi i një rruge e cila medoemos të depërtohet nga zero edhe atë në teren malor, kushton vetëm 12.533 den për metër rrugë gjatësie. Çmimi real është shumë më i lart (sipas të dhënave për projekte të tilla të realizuara dhe sipas tenderëve)

Keqpërdorimi i funksioneve për qëllime parazgjedhore

Të gjithë institucionet nacionale dhe lokale, në periudhën parazgjedhore mendojnë aktivitete, ku do të paraqitet kandidati dhe projektet e tyre ja përshkruajnë kandidatit (kryetarit) gjoja se ai i ka realizuar.



Përkrahja e biznesit të vogël dhe të mesëm

Askush nuk e din çfarë donë të thotë më saktësisht kjo, por kjo takohet tek të gjithë kandidatët e të gjithë partive.

Mos mbajtja e llogarisë për pasojat nga projektet

Ekzistojnë projekte tek ofertat, për të cilat nuk kujdesen se çfarë pasoja mund të sjellin kur shihet më gjerësisht interesi shoqëror.

Ashtu, kandidatët premtojnë ndërtimin e një rruge, e cila trasohet në zonë arkeologjike të pa gjurmuar deri te një kishë apo manastir shumë thelbësor e cila është në fazë të intervenimit përkatës dhe gjurmim arkeologjik, gjegjësisht komplet e pasiguruar për vizitë.

Planifikohen rrugë afër lokacioneve të cilat janë të njohura si kulturore, rezervate të botës bimore, lokacione me zero ndytësi, të cilët do të jenë të rrënuara n.q.s nuk ka qëndrim të qartë dhe hymje komplete shkak që aktualizohen disa rrethina? Mundësimi masovik i hymjes deri tek këto vende është gabim, të paktën në kohë kur nuk ka turizëm më inteziv, as shansë që ajo të ndodhë në një kohë afat shkurt dhe/ose afat mesme. Oferta të tilla ka në katër komuna të pelagonisë.

Ndërtimi i **vendbanimeve** të mëdha për strehimit

Këto vendbanime janë të planifikuara për dhjetra mijë banorë, me nxemje qendrore, kopshte, shkollë, qendra sportive, qendra tregtare. Ku ti gjejmë këto banorë të shumtë? Në pelagoni nataliteti është minus, por ka edhe migrime jashtë vendit të përhershëm.

Tregu i patundshmërive tregon rrënie të interesit për blerje e shtëpive dhe banesave.

Sigurimi i lokacioneve për hapësirë **afariste**

Duke marrë parasysh zvogëlimin drastik të numrit të subjekteve biznesi në Maqedoni (nga 120.000 në 72.000), mbyllja e shumë lokaleve, shumë lokaleve të pa dhëna, zhvillim i vogël... lirisht mund të themi se në pelagoni nuk ka nevojë për më tepër hapësirë afariste. Dëshmi për këtë deklaram është rrënja e çmimeve për marrjen e hapësirës në tërë regjionin, përveç në qendrat kryesore të qyteteve si dhe lokaleve të pashitura në qendrat tregtare. Pikërisht, mbledhja e neto qirave për 10 – 15 vitet të hapësirës së dhënë për biznes duhet të jetë më lartë nga harxhimet e luhatshme të investimit për periudhën e njëjtë (mbledhja e: kamata bankare e pamarrur të mjeteve të investuara, tatim për hapësirën e dhënë afariste, përmirësimeve...).

Numërimi i projekteve me buxhet të theksuar dhe patheksuar, njëri pranë tjetrit

Pas numërimit të projekteve shkruhet njëfarë buxhet të përmbledhur, por nuk dihet se për cilat projekte nga të përmendurit punohet. Ashtu që nuk mund të kontrollohet sa para kanë, për cilën rrugë, për cilin fshat. Në të gjitha programet vetëm disa projekte kanë buxhet të llogaritur, ndërsa në të njëjtën grup projektësh ka dy – tre projekte, për të cilët vetëm theksohet se kush do të jetë investitori dhe në fund të kësaj pjese vendoset njëfarë buxheti, pa e ditur se a do të hyjnë edhe buxhetet e radhitura në të ose ajo është vetëm për projektet pa buxhet të theksuar.

Të gjitha rrugët do të asfaltohen

Strategji e dëmshme për fitimin e votave, e cila pas asaj të gjithë neve na thyhet në kokë. Pikërisht për një shumë, shumë të vogël përmendet asfaltimi dhe riasfaltimi i një numër të madh rrugicash. Pas asaj kandidati – atëherë prefekt ka problem me aq pak para (të holla) të asfaltonte gjithçka çfarë ka premtuar, dhe mundohet me arminin e rrugëve, vendosjen e asfaltit të holle...

Ngjyrosja e fasadave si rindërtim i fasadave

Lyerja e fasadave prezentohet si rindërtim i fasadave, për ato që i lexojnë vetëm titujt.

Rregullimi dhe mirëmbajtja e....

Në ofertat e kandidatëve mirëmbajtja e parqeve të caktuara dhe sipërfaqeve tjera, që është punë e rregullt e ndërmarrjeve komunale, titullohet si rregullim dhe mirëmbajtje.

Një projekt ndahet në segmente, me qëllim që e arritura të duket më e madhe

Në vend se të thuhet është asfaltuar rrugica, tregojnë se kanë asfaltuar 4000m² me kënde të rregulluara, sinjalizim të vendosur, shenja të vendosura, rrugë për këmbësor me atë të mendojnë të gjithë se është punuar shumë.

Projektet numërohen veç e veç e pastaj përsëri të gjithë së bashku në grupe së pari veçanërisht

I radhisin projektet, e pastaj e gjithë ajo vendoset në grupe: rrugë të asfaltuara, ujësjellës, kanalizime... ashtu lexuesi duhet të mendoj si dyfishitë është punuar. Projektet më kryesore radhitet edhe si prioritativë dhe në veçanti.

Shumë nga projektet e njëjta janë regjistruar në kapitujt e ndryshëm të programit.

Vendosja e gur themeleve e pastaj e pastaj flitet për interesim që do të kenë qytetarët nga ai projekt sikur projekti është i realizuar. Po ashtu shpeshherë vendosjen e gur themeleve për të njëjtin objekt, të cilin ndonjë në faza gjatë ndërtimit, e pastaj për secilën fazë bëjnë fushatë sikur të jetë e filluar nga fillimi. Ashtu kanë prerë shirita edhe për rrugë të tamponuara edhe për asfaltim edhe për vendosje të pajisjeve.

Shitja e vendeve në **zonat industriale** konsiderohen si investime të realizuara

Kur shitet ndonjë parcelë në ato zona, ato flasin se gjoja ka interes nga ana e investitorëve dhe se priten investime të mëdha.

Punësime në fabrika të pandërtuara

Me shitjen e një numër të madhë parcelash në zonat industriale kandidatët flasin se çfarë do të ndërtohet dhe sa punësime do të bëhen (Në fabrika të pandërtuara).

Përmendja e vendeve të reja pune në objekte shërbimi dhe objekte tregtare private

Qendrat e këtitilla tregtare nuk prodhojnë vlerë të re, nuk sjellin para të reja në komunë por, vetëm vjedhin nga parat ekyistuese (ato që do të vijjnë atje, do të shpërngulen në lokale tjera, ata që nuk do të parkojnë në parking tjetër të caktuar do të parkohen atje...).

Qyteti ka nevojë të kufizuar për numër të caktuar lokalesh, parkingje, shërbime... që tregon se nuk mundem të shpresojmë se qendrat tregtare do të kenë efekte tjera, përveç afatshkurte me vet ndërtimin.

Ndërtimi i më shumë zonave ekonomike – industriale dhe hapja e zonave të reja

Secili njeri i mençur s'ç pari do të pres që të hapësh biznese në zonën e parë, e pastaj të hap e dytën.

Promovimi i komunës për tërheqjen e investimeve të mbrendshme dhe jashtme

Kjo përmendet si projekt dhe shihet se është shkruar sat e themi së është shkruar diçka. Secili don investime të huaja, por promovimet doemos t'i udhëheq dikush, ai i cili din ta bëjë atë.

Nëse qeveria nuk ariti të tërheq investime, me gjithë ato shëtitje që i bëri nëpër botë me gjithë ato institucione të formuara për tërheqjen e investimeve, me punësime plot, reklamimet nëpër gazeta e huaja që janë shumë të shtrejta, televizione, për shkak të së cilës tani vërteton se komunat do të mundën ta bëjnë këtë, që nuk mund ta bëjë qeveria.

Ndërtimi i centraleve për përzgjedhjen e mbeturinave, djegjen e mbeturinave dhe prodhimin e energjisë elektrike dhe bio-gazit.

Këto janë projekte shumë afanzive dhe evizionale, të cilat janë trend evropian, por ato duhet të jenë në deponitë, ku duhet të ndërtohet qendër për selektim.

Selekcionimi (sekondar) i mbeturinave nuk është edhe aspak afër fabrikës për prodhimin e energjisë elektrike ose bio-gaz, përveç

nëse bëhet fjalë për fabrikë të vogël. Centralët për djegjen e mbeturinave kërkojnë dituri, e cila mund të fitohet me blerjen e centralës. Këto projekte kërkojnë të dhëna plotësuese për qytetarët dhe medoemos të udhëhiqen fushata një kohë më të gjatë. Si do që të jetë, besojmë se, përveç selektimit sekondar të mbeturinave pelagonia nuk është e përgatitur për të aritura më të mëdha në këtë lëmi. Bio-gazi i fituar me digjestim anaerob është punë edhe më e shtrenjtë.

Gazifikimi i komunave nga "Rrjedha e jugut" deri në vitin 2016.

Gazifikimi deri në kufijt tona do të jetë i përpunuar deri në vitin 2019. Deri më tani nuk ka dokumentacion për gazifikim e lëre të ketë plane për gazifikimin e komunave.

Megjithatë, gazifikimi është gojat dhe programet e gjith partive (p.sh i strumicës i inspiron të tjerët)

Projekte të financuar nga investitor ndërkombëtar

Disa projekte do të finansohen me kredi nga banka botërore dhe BiE, por mbulohet se komunat do të borxhitën nga ky kredit për disa projektet e tyre. Kandidatët deklarjnë vetëm atë se projekti do të finansohet nëpërmjet MSIP dhe asgjë më tepër. Ai është projekti për përmirsimin e shërbimeve të komunave, të cilin banka botërore e finanson nëpërmjet kredisë, ndërsa qeveria u jep komunave nën-kredi.

Projektet për nënstacione të reja dhe rrjeta energjetike

Ato janë projekte të EVN dhe nuk është e qartë për çfarë shkak shkruehen si partneritet në komunë.

Futja e transportit urban

Punohet për projekte për sigurimin e autobusave dhe minibusave ekologjik me shtytje elektrike, por mjetet e lartpërmendura janë pak për t'u siguruar këto automjete (shembull në një program përmendet se komuna do të siguroj disa autobus dhe disa minibus elektrik për 3 milion den.)Nuk jepet sqarim se kush do të kontrollojë me këto autobus. Projekt që do të kishte qenë i mire nëse realizohet, nuk ka ardhmëri nëse në transportin e udhtarëve kyqet direkt komuna.

Projekte për rininë dhe sportet

Si është e mundur kandidatët e pozitës në pushtet t'i kenë njësoj projektet?

Ato projekte që nuk janë të përbashkët janë të shumta tek të dy partitë akuapark, komplekse hotele. Këto projekte janë aq të shumta tek të dy partitë më kryesore, që janë përkatësisht të njejt (gjithçka u është kujtuar kanë shkruajtur).

Aktivitetet të thjeshta paraqiten si projekte

Mbajtja e debeteve, aktivitetet të njëkohshme, përkrahja e kësaj dhe asaj.

Projekte të paarritshëm dhe krejtësisht joreale, për të cilat ne kemi zero njohuri.

Projekti i propozuar është për një qendër botërore për sportet eksterne, edhe pse kemi zero njohuri këtë t'a realizojmë (Ky lloj turizmi kërkon kapacitete njerëzore përkatëse dhe specifike).

Një tjetër projekt qesharak Manastiri qytet i filmit, për cilën nuk do të kisha hargjuar 100 000 000 den. Nëse jo joreale disa projekte janë të panevojshme. Ashtu ekzistojnë projekte për ndërtimin e objekteve kulturore komunale shumëshërbimesh, përdërisa në të njëjtën komunë ka plot hapësirë të papërdorur për kulturë.

Ndërtimi i objekteve të banimit në banime sociale.

Ndërtuar këto banesa kushtojnë rreth 25000 euro për banesë. Shumë për banesë sociale për ato para ka banesa edhe më gjerë në qendrat e qytetarëve të cilat nuk janë sociale.

Projekte për punë publike në komunat

Ato janë të punësuarit pastruesit e rrugëve të cilat janë përgjegjës për kryerjen e punëve publike (thuan që janë njerëz të cilat janë të kategorisë sociale të lënduar). Të tilla i ka në çdo hap. Këta janë projekte të llojit më të ulët.

Hapja e qendrave të veçanta për informim të rregullt të bujqëve.

Edhe tani e kemi agjencionin për përkrahjen e bujqësisë me 44 zyra të tilla.

A mendon partia që ti hedh të punësuarit nga agjencionin e cila nuk e arsyeton ekzistimin e saj.

Mbështetja për formimin e operativave bujqësore, s'ka nevojë nga përkrahja e tillë kooperativat formohen vet edhe pa qeverinë edhe komunën. Ajo është një funksion i një sistemi para vitit 1990.

Tërheqja e investitorëve duke lehtësuar kushtet për ndërtim, lokacione për qendra grumbullimi dhe 1000

Megjithatë të gjithë pamë se këto masa nuk sollën asnjë investitor. Sasia prodhim në nënsektoret e shumta bujqësore është e vogël dhe jo e standardizuar për shtëpi profesionale për distribuim të prodhimeve bujqësore nga jashtë, ndërsa çmimet tek ne janë shumë të larta për dallim nga konkurrencave nga jashtë, ndërsa çmimet tek ne janë shumë të larta për dallim nga konkurrenca nga jashtë, prodhimi nuk është sipas standardit Evropian. Të gjithë këta projekte do të harxhojnë para për qejf të sunduesve, ndërsa efektet do të jenë zero.

Ndërmjetësimi dhe përforcimi i bashkëpunimit ndërmjet bujqëve dhe përpunuesve.

As pushteti lokal as qeverisja s'ka kapacitet dhe dituri për ndërmjetësim. Ky është sektori privat dhe secili investim i qeverisë do të shkakton çrregullim i tregut. Tregu medoemos të rregullohet vet. Edhe deri tani u hodhën shumë para për ndonjë forcë ndërmjetësimi por gjith mbaroi me paratë e buxhetit të cilët nuk sollën zhvillim.

Mbështetja për ngritjen e mirë e kapaciteteve përpunuese

Nëse ka logjikë ekonomike nuk është e nevojshme përkrahje e tillë. Tani për tani, problem kryesor për sasinë e prodhimit të kësaj industrie është zvogëlimi i kërkesave nga jashtë prej 27%, kërkesa e pamjaftueshme e mbrendshme prej 19%, pasiguria ekonomike në rrethinë prej 11.4% dhe problemet finansore me 9.5%, ndërsa kapacitetet i kanë shfrytëzuar 60%. Domethënë nuk kanë problem prodhuesit me taksat komunale dhe tokën, por me gjendjen e përshkruar më lart, ndërsa në nivel lokal me donacionet e larta të cilat medoemos t'i japin në bazë partiake, Të dhënat tjera të mbuluara, mitoja në urbanizëm, standardet e larta, të cilat janë të shtrenjta për privatet, ndarja e parregullt të çfarëdo qoft dotacioneve nga ana e shtetit etj. E gjithë kjo shpeshherë e diskutuar nga odat ekonomike dhe saktë u është theksuar përfaqësuesve shtetëror dhe lokal se ato janë problemi kryesor të kësaj industrie.

Ndërtimi i qendrave grumbulluese – distributive me investime private

Ska investitor i tillë që do të ndërtoj në vend që ia ka përcaktuar shteti, të paguaj nga gjepi i ulët e të vetë ndikim i hapur dikush tjetër. Edhe të mos jetë ashtu praktika e deritanishme ka treguar se këto qendra grumbullimi nuk funksionojnë tek ne.

Mashtrime nga mosdituria ne zhvillim të turizmit.

Nuk ka kandidat i cili turizmin nuk e ka vendosur prioritet në komunën e vet.

Në bazë të atij prioriteti shkruhen projekte, të cilat tek partia në pushtet janë të standardizuar gjithkund (intoksioskat turistike, harta, kartolina urimi, promovimi i panairëve komunale, trajnime për turizëm....).

Cilët kushte të veçanta i kemi për zhvillimin e turizmit, që të tjerat si kanë? Ku janë turistët që t'i informojmë nëpër kioskat, t'u ndajmë kartolina, harta, urime? Cilat oferta i kanë agjencionet tona turistike? Çka promovojnë nëpër saeme?

Ndërtimi i objekteve feture nga buxheti i komunës

Ato janë të shkruara në artikull mbrojtja e trashëgimisë kulturore dhe nuk janë kur farë mbrojtje, por xhami dhe kisha të reja, rregullim parter përreth tyre, ndriçim.

Mbrojtja e zanateve të vjetra

Këtu mendohet për zanatet e artit, por për fat të keq ato më tepër s'janë. Çfarë atëherë duhet të mbrohet?

Rekonstruimi i malit monoment i natyrës dhe kulturës.

Çfarë duhet të rindërtojmë? Shkëmbijt? Do të bëjnë shkëmbje të rinj prej gipsi?

Ky është monumenti i natyrës dhe kulturës, kështu që nuk dihet se çfarë do të rindërtojmë? Muret? Projekti i këtyre për rindërtimi e mureve mund të implementojë vetëm shteti, deri më tani të gjithë institucionet edhe shteti nuk aritën të bëjnë as dokumente planifikuese, plane për udhëheqje e jo rekonstruim.

Projektet që i zbatojnë institucionet nacionale regjistruhen si lokale.

Devijimi i ndërtesave të kazermave dhe ndërtesave tjera publike konsiderohen si sukses.

Më tepër lirohen ndërtesat për përdorimin e administratave numri i të cilëve rritet për së tepërmi. *Projektet tjera konsiderohen si zhvillim ekonomik lokal, ndërsa kanë të bëjnë vetëm me strehimin. Pikërisht, punohet në projekte për shëndrim, përshtatje për ndërtim të një zone banimi dhe hotele. Infrastruktura e ndërton komuna, por më vonë gjithë atë e paguan nga blerësit. Kush është i çmendur të ndërtoj hotele, kur më shumë se 50% të objekteve ekzistuese të hoteleve nuk janë duke u përdorur në pelagoni.*

Shitja e parcelave në zonat industriale prezantohet si investim i huaj

Të gjithë parcelat janë të blera nga qytetarët tanë, por reklamohen si interes i huaj, jo rallë merren qytetarë të huaj me qëllim që ti shëtisin nëpër zonat ose të paraqiten në licitime.

Premtimi i manifestimeve për diasporën për shkak të investimeve

Kandidatët e dinë se kjo është punë e gabuar (Askush nga diaspora jonë nuk ka investuar mjete të konsiderueshme) por duan ti iniciojnë ata që kanë njerëz të afërm në vendet e huaja.

Formimi i këshillave për zhvillim ekonomik

Në të shumtën e rasteve ato janë të formuara si trup shumë partiak me mbizotërim të odave ekonomike, konfederatave të biznesit dhe shoqatave të artizanëve. Efekt nga formimi i tyre deri më tani s'kemi parë, nga ana tjetër ajo duhet të iniciohet nga sektori i biznesit i jo – i politikës.

Formimi i unionit të këshillave të prindërve dhe këshillave të arsimtarëve

Si projekte komunale pothuajse të gjithë kandidatët e partisë në pushtet i ofrojnë këto projekte. Për çfarë? Këto janë forma të organizimit me të cilat nuk duhet të përzihet politika. Nuk tregohet edhe ajo që nuk është bërë paraprakisht, dhe e cila do të përmirësohet me këto projekte. Kjo është shpenzim i pakuptimtë i parave.

Projekti arsim për të gjithë (Arsim për të rritur)

Nuk ka indikacione se cilat trajnime do të financohen, për cilat, a janë kërkuar trajnime të tilla nga pronarët, kush do ti realizon. S'ka arsytim kështu të prezantohet një projekt.

Projekti “nuk ka dyer të gabuara”

Ky është projekt qeveritar, pa pasoja dhe e vlerësojmë si propagandë e pastër. Të punësuarit nëpër shaltere ishin të sjellshëm, por procedurat janë shumë të komplikuar, që të arsyetohet punësimi i madh. Kjo në veçanti vlen për administratën shëndetësore.

Heshtja – d.m.th miratim

Heshtja e administratës vazhdon më fort se kurrë. Në vitin 2011 ajo është e lejuar me ligj, me veprim ankese të pabesueshme, në të cilën ka aq hapa sa që njerëzit nuk mund ti numërojnë.

Gjotinë administrative

Kandidatët e përmendin në të gjitha programet, por kjo është një mashtrim. Të gjithë dekretet komunale janë bërë nga ligjet e aplikuara në ministri të caktuar kështu që nuk dihet çka munden komunat të gijtojnë nga aktet kryesore të cilat harxhojnë kohë, para, durim i qytetarëve.

Projektet qeveritare dhe zyrat e themeluara, organet, agjencitë e zhvillimit... janë paraqitur si një sukses i madh, por në fakt ato janë trupa pa ndonjë efekt.

Të gjithë projektet janë të suksesshëm pa i vlerësuar dikush nga anash.

(vet planifikojnë, vet ndërtojnë, vet vlerësojnë çfarë dhe sa suksesshëm kanë punuar)

Prezentimi i info qendrave turistike dhe planet e mëdha të tyre

Është punuar shumë pak, kuadri i shumë, ndërsa shërbimet që i ofrojnë mund t'i kryej një punonjësi i Informatikës.

Formimi i klubeve sportive nëpër shkolla nga buxheti i komunës.

Ky është lloji më i ulët intervenimi, me të cilën shkatërrohet sporti dhe iniciativa private.

Nëse i formon dikush nga jashtë, nuk ka të zhvilloj forcë e brendshme në shkollë, nuk do të shihet kualiteti i profesorëve, i fëmijëve, s'ka konkurrencë, d.m.th – s'ka as kualitet.

Formimi i këshillave lokale rinore, pregatitje strategjike lokale i të rinjve, qendrave informative për të rrinjt.

Projekte të tilla duhet të jenë plotësisht të ndaluara për komunën, për shkak se organizimi i të rinjve nuk duhet të jetë punë e shtetit apo vetëqeverisjes lokale. Ajo na qon në partizim të hapur dhe ndikim joligjor mbi adoleshentët.

Debat për ngritje e ndërgjegjësisë të të rinjve për ndërmarrësi

Aktivitet pesë lekësh vendoset në program si ndonjë projekt kush e din çfarë. Çfarë dinë komunat për ndërmarrësi? Sikur të dinte nuk do të kishte më pak projekte në pikën zhvillim ekonomik lokal, nga të cilat projekte të gjithë janë të dyshueshëm. Përse komuna do ta organizonte një debat të tillë.

Projekte të tipit “aktivitete të donatorëve”

Kuptohet, e zakonshme është donimi të rikthehet në reket. Këtu nuk punohet për përgjegjësi shoqërore të ndërmarrjeve. Kur prefekti i fton biznismenët të donojnë, ato nuk guxojnë ta refuzojnë, sepse pastaj menjëherë i viziton inspektorati.

Fushata të tipit “Stop veset”

Komunat nuk duhet të merren me punë të tilla. Kjo nuk është punë e komunave, por e sektorit OJQ, ASM, MPB. Pas një fushatë të tillë komunale lirisht mund të presim këto vese zhvillohen.

Fushatë për gjakdhuruesit

Deri ku kanë arritur partitë mund të shihet nga fakti se premtojnë se do të organizojnë aksione të tilla. Kjo të shkruhet në programet e partive politike? Shumë ulët dhe mjeruese.

Zero tolerancë për projektet e deponive ilegale (partia në pushtet)

Pohim qesharak, duke pasur parasysh se kudo rreth qytetit ka plot deponi. Për çfrë është i nevojshëm projekti? A nuk ka institucion i obliguar i cili e ka këtë punë të përditshme?

Shkrimi i projektit plotësisht të ndryshëm nga një artikull, me qëllim që të mos shihet për cilin projekt do të shpenzohen paratë.

Vet punësim, subvencione për këtë qëllim, para për trajnim.... nuk është efektive vet të punësohesh.

Parimisht duhet të regjistrosh firmë ose të jesh kontraktues i pavarur. Në të dy rastet humbet ndihma sociale si dhe beneficinet tjera nga sfera e sociale, pronari i firmës fshihet nga lista e të papunësuarve nga enti për punësim. Pastaj paraqiten detyrimet financiare që janë aktuale dhe që i ka në fillim të punës. Nga dija që e kemi ne, nuk ka asnjë firmë aktive, e formuar prej qytetarëve, krediteve për vetë punësim ose nga UNDP-ja. Firmat edhe më tej numërohen si aktive kurse pronarët nuk mund të paraqiten si të papunësuar, nuk mund të shfrytëzojnë e drejtën për ndihmë sociale, si dhe nuk mund të punësohen jashtë vendit në shumë shtete me të cilët kemi lidhur kontratë, për shkak se nuk i punësojnë pronarët e firmave jashtë vendit (shembull i tillë është Sllovenia).

Punësime në ndërmarrjet komunale për një periudhë të caktuar

Edhe kjo mund të jetë ndonjë ndihmë për të varfërit, por kjo shpeshherë zgjat shumë shkurt, humbet ndihma sociale, kemi fshirje nga lista e të papunësuarve. Dhe tani këto ndërmarrje komunale janë përplot me të punësuar të panevojshëm.



Programe anti-krizë

Qeveria plason projekte nga të cilët do të punësoj numër të madh të papunësuar në peshë të buxhetit (rreth njëmbëdhjetë milion euro vetëm për një program). Ato i quan antikrizë 8 mijë punësime të reja (ku 4000 do të punësohen nëpër komuna) do të punësohen edhe nëpër punë publike, tek ndonjë punëdhënës i njohur, do të vetë punësohen, do të bëhen bujq të cilëve do t'ju jepet tokë shtetërore, do të punësohen nëpër institucione....ndërmarrjet do të fitojnë dhjetëra milion euro për punësimet dhe trajnimet e këtyre personave, përderisa afër 80% nga këto ndërmarrje s'mund të lidhin fund- me fund me të punësuarit që i kanë.

Shteti jep edhe nga 5 mijë euro për një të punësuar vetëm e vetëm të përhapet ndonjë vend të rij pune. Agjencioni NEPA krijonte vende pune deri në vitin 2002, të cilët mesatarisht shtetin e kushtonin përafërsisht 15 mijë euro për person, por pas ndërprerjes së donacioneve ai lëshohej nga vendi i punës. Personat social që të bëheshin bujq shteti do tu ndante nga 850 hektar tokë. Ja kështu qeveria tallej me bujqit dhe fermerët e suksesshëm. Për 1 mijë njerëz do të ndahen nga 4000 denarë në muaj përderisa ato janë në trajnim tek ndonjë punëdhënës, e pastaj? Përse ndërmarrjet të trajnojnë? Për 4000 den, në muaj e pastaj t'i punësojnë? Qesharake. Në masat gjeniale të qeverisë mund të lexohet se bujqit do të munden t'i regjistrojnë traktorat dhe maqinat si dhe t'i legalizojnë objektet e ndërtuara pa të drejtë. Kuptohet, bujqit do ta humbin ndihmën sociale.

Rritja e eksporteve

Nga statistikat shihet se bruto eksporti është rritur kundrejt atij nga viti 2006 dhe atij nga viti 2002 deri në vitin 2006, gjithmonë ka qenë në rritje. Megjithatë eksportet konkurrojnë me importet për të parë nëse kemi deficit tregtar apo të tepërt. Aty s'kemi çka të lavdërojmë për shkak se aty kemi balans negativ për ne (shumë më tepër importojmë se sa eksportojmë). Edhe në strukturën e importit bien produktet me vlerë të lart të shtuar, sjellin më tepër repromateriale të lira, ndërsa bartim mallra të shtrenjta finale.

Sjellja e ligjeve evropiane

Kemi arritje formale (ligje të sjellura). Nuk është e mjaftueshme vetëm të sillen një ligj por duhet edhe të krijohet një institucion për mbikëqyrje, të trajnohen njerëzit, të vendoset në teren një sistem efikas ose inspektim, të sigurohet vëzhgim në zbatimin e ligjit. Adoptimi është i ngadalshëm dhe pa qëllime prioritare, ato nuk i ka sepse s'ka participim, ndërsa atë se ka për shkak se institucionet qeveritare duan të punësojnë udhëheqës partiak në vend të udhëheqësve dhe ekspertëve të aftë. Ka sektor komplet që nuk janë të rregulluara ashtu siq duhet të jenë: investimet, trgti elektronike, lidhje doganash etj. Ekzistojnë barriera jotarifore si pasojë e shpejtësive të ndryshme të miratimit të rregullave dhe standardeve të BE-së.

Paraqitja e projekteve të përbashkëta për të aplikuar në BE

Si prioritet të lart e përmendim këtë artikull. Kush deri më tani i mbron? Maqedonia aplikon tek IPA instrumenti qysh nga viti 2007 dhe deri më tani shumë pak janë shfrytëzuar.

Kompjuter për çdo fëmijë dhe qasje falas në internet

Ka të dhëna se kompjuterat nëpër shkollat janë të prishur dhe nuk përdoren. Për çfarë nevojitet atëherë interneti?

Decentralizimi i kulturës

Në programet flitet për atë, si e arritur e kaluar, e cila do të jetë e përpunuar. Por ajo e dhënë është e pasaktë. Pothuajse të gjithë institucionet nga lëmija e kulturës përveç bibliotekave, janë të nivelit shtetëror (drejtim nacional). Kryetarët e komunave nuk kanë kuadro dhe shumë pak investojnë në kulturë.

Politika e zhvillimit të balancuar (barabartë)

Programet janë të mbushura me zhvillim të barabartë, por kjo praktikë nuk respektohet. Edhe ndërkombëtarisht jemi të notuar si shtet, në të cilin zhvillimi i barabartë nuk respektohet.

Mjekimi jashtë vendit me participim prej 200 euro nga ana e qytetarit që mjekohet.

Deri më tani, sigurimi social duhej të mbulojë 80% për mjekim jashtë vendit.

Huamarrja për të mirën e qytetarëve (mbështetje buxhetore). Buxheti është ligj.

Qeveria është e obliguar që ta zbaton buxhetin, njësoj siç është e obliguar në pajtim me ligjet tjera.

Qeveria, pa parlamentin shpalli se deficitit buxhetor për rritjen prej 2.5% në 3.5%, ky është mashtrim me huamarrje publike. Qeveria nuk deshti që t'i zvogëloj luksozet e saja të cilat përbëhen në blerje të mobileve, veturave, mëditje të rritura për udhëtime zyrtare për funksionarët... por më tepër për subvencionimin e bujqësisë për të cilën u dëshmuar se janë plotësisht të gabuara (qeveria paralajmëroi se do ti forcojë kriteret për subvencionimin e bujqësisë edhe pse nuk pranon se këto subvencione dhenë rezultate të kundërta).

Përfitime të ndryshme dhe lehtësime për qytetarët apo firmat

Falja e të dhënave dhe dhënia e përfitimeve jashtë logjikës tregtare është masë shumë e dëmshme. Kjo është njësoj sikur një person që mbytet ti japësh amvil në të cilin ka balon të fryer.

Fshirja e borxheve për pensione, sigurime sociale si dhe taksave tjera të papaguara prej ndërmarrjeve.

Këto para të humbura për ndërmarrjet janë falje të parave që si kanë paguar, dhe me atë prishet tregu, për shkak se dikush tjetër atë të dhënë e ka paguar. Nuk mund të vendoset sistem "pagan kush ka" ky është një mesazh i gabuar për disiplinën fiskale dhe të tregut. Si rezultat i tolerimeve të tilla të shumta (vetëm për disa ndërmarrje) vetëm kamatat e borxhit të tillë për sigurime pensionale kanë arritur 40% nga borxhi kryesor. Për atë shkak me dy ligje qeveria u mundësoi mos paguesve të paguajnë pa ua kërkuar kamatën e mbetur. Nëse deri tani s'kanë paguar, pse të paguajnë tani?

Ndërtimi i shëtitoreve, sheshëve, monumenteve... nën velon e standardeve sociale dhe jetësore.

Qartë është e konstatuar nga qytetarët se nëpër të gjitha komunat mungojnë: kopshtore, shkolla, ambulanca..... por këto janë projekte të shtrenjta dhe ndërtimet e ulëta mbeten alfa dhe omega për prefektët – edhe lëvdata edhe përfitime.

Lakmia, e maskuar si shqetësim për buxhetin komunal

Kishte përpjekje për tu futur tarifa për vikend turistat që kanë banesa – vikendi (prej 100 – 200 euro për mysafirë). Si mund të jetë mysafirë, nëse ka shtëpinë e vete në Ohër dhe pagan tatim për shtëpinë.

Ekzistojnë leje të fshehta për para çdo zgjedhjeve për prerje të lirë të pyllit

Me qëllim që të kënaqet edhe shtresa e varfër, në veçanti romët për të cilët ky është biznes kryesor dhjetëra vitesh. Policia nuk furnizohet me karburant për tu siguruar nga prerja, ndërsa inspektorët e pyllit janë të demotivuar nga fakti se në gjyq këto raste sociale lirohen. Ato vetë theksojnë se kriminelët kryesor të prerjes janë nën mbrojtjen e politikës përderisa, Romët vetë i lëshojnë të presin dhe më pas ato ti dënojnë. Përsëri ka projekt për "Zero tolerancë" të prerjes së paligjshme.

Ekziston vendim sekret për mos sanksionimin e shoferëve para zgjedhjeve

Vetë policia këtë e vërteton. Ato mund të ndalojnë automjete por jo edhe ti dënojnë, me përjashtim të veprave të rënda, të dehurit etj.

Sinqeriteti dhe transparenca e komunës përmes takimeve me qytetarët

Hipokrizi: Ditët e hapura në komunë përdoren për propagandë. Askënd kryetarët e komunave nuk kanë thirrur për këshilla profesionale, as kanë thirrur shoqatë me anëtarësi profesionale. Kjo është edhe vërejtje ndërkombëtare. Megjithatë kjo për kandidatët nuk është ndonjë prioritet. Idejat e mira nuk shpërblehen, nuk merren si të rëndësishme, ndërsa më pak të rëndësishmet mbeten prioritet të qytetarëve, përderisa anketimet thonë se qytetari mendon se nuk është i kuptuar seriozisht. Ekspertët aspak nuk vijjnë në këto takime.

Dita e pastrimit të deponive të egra dhe mbjellja e sipërfaqeve të gjelbërta

Gjithë vitin lejohet hedhja e mbeturinave kush – ku do të mbërijë e pastaj bëjnë aksione. Njëkohësisht policia nuk ka para për karburant për kontrollimin e hedhjes së mbeturinave, ndërsa inspektorati vjen vetëm me akuzë.

Raporto vrimë raporto problem

Hipokrizi e paparë e pushtetarëve komunalë. Në ndërmarrjet komunale ka me qindra të punësuar pastrues dhe personal rrugor, ndërsa dikush medoemos të paraqes problem. E gjithë kjo u shërben për tu arsyetuar gjoja se nuk kanë ditur për vrimat, për shahet nëpër rrugë.

Donacioni nga qeveria për blerje të çfarëdo qoftë, ndërtimi.....

Qeveria nuk mund të japë donacione ato janë para buxheti dhe nuk mund të thuhet se qeveria i ka donuar por se i ka harxhuar nga buxheti. a është ai harxhim i arsyetuar a jo? kjo është pyetje e madhe.

Ndihma emergjente (e shpejtë) dhe ndihma e njëhershme financiare

Turp është të paraqiten raste sociale, që kanë marrë mjete të tilla para kamerave, për tu lavdëruar, pushtetin lokal, ndonjë institucion, qeveri....e gjithë kjo është imorale.

Falë kryetarit të komunës

Prefekti harxhon financat e qytetarëve dhe nuk guxon të reklamohet para ndonjë ndërtimi, harxhimi....ai nuk shet patate por ato janë paratë e qytetarëve. Atë e ka punë. Përse nuk e lavdërojnë zjarrfikësin që e shuan zjarrin, mjeku që shëron apo ndonjë punëtor që gjithë ditën është duke punuar.

Projekti për sigurimin e pagave shtesë prej 30% më shumë

Secili student inxhinier, teknolog dhe informatikan, pas përfundimit të studimeve jashtë vendit do të kthehet dhe do të punojnë në Maqedoni. Kush nga këto do të ishte kthyer që të marrë 30% më shumë nga e para tepër se zero (nuk ka punësim).

Ndërtimi i hidrocentraleve

Sipas të dhënave nga banka kombëtare, importi i energjisë elektrike për periudhën 2006-2011 ishte 1 miliard e 127 mijë dollarë. Nga ana tjetër ndërtimi i HC sveta petka arrinte 75 milion euro. Me paratë që janë dhënë për të importuar energji elektrike. Kanë mundur të ndërtojnë mbi 15 objekte energjetike si HC sveta petka.

Lavdërimi me projekte, të cilat nuk janë të kandidatit dhe të komunës

Shpeshherë kandidatët lavdërohen me projekte, që janë private përderisa këto vetëm e presin shiritin. Rast tjetër është kur edhe qeveria edhe prefekti lavdërohen me të njëjtin projekt.

Zvogëlimi i papunësisë

Shteti bëri një numër të madh mashtrimesh për zvogëlimin e papunësisë në administratë. Parimisht janë punësuar një numër të madh nëpër institucionet dhe vetëqeverisjet lokale (punësime joproductive). Pastaj, administrativisht janë fshirë dhjetëra mijë të papunësuar (edhe për funksion në organizat jo qeveritare edhe pse sjanë të punësuar dhe pa rrogë). E treta, sjellja e arsimit të detyrueshëm në shkollat e mesme, studimet e disperzuara në fakultet, të cilët mbajnë dhjetëra mijë të rinjë në agjencioni për punësim i RM-së.

E fundit, kuadrët e arsimuara shkojnë jasht vendit.



Bashkëpunimi ndërkombëtar

Për fat të keq, këtu s'kemi as projekte, as dituri, për çka përgatiten punime të cilat janë të publikuara në faqen tonë të internetit. Fakt është se atje ku duhet të ketë më shumë projekte (për shkak se kemi investime të huaja) ato nuk i kemi, ndërsa atje ku punohet për huamarrje nga ana e shtetit dhe komunës – projekte sa të duash. Përkisht, komunat mund të kërkojnë mjete financiare për mbulimin e harxhimeve gjatë binjakëzimit (ndërmjet veti të dy ose më tepër komunave në formë të një rrjeti komunash të binjakëzuara). Përgjigjja për zbatimin e binjakëzimit është educatio, audiovisual end culture executive agency (EACEA) në europe citizens programme ku nëpërmjet aksionit 1 (action 1) ka masa që mundësojnë aplikimin për grante (mbështetje për binjakëzim dhe rrjetat teorike binjake të qytetarëve nga BE). Deri në vitin 2012 këto programe Maqedonia i përdori vetëm në tre grante.

Qeveria punon në emër të qytetarëve, komunat punojnë në emër të qytetarëve.....
E çfarë të punojnë qytetarët


Kapitali njerëzor është aq i rëndësishëm, aq sa dinë të bashkëpunojë ndërmjet veti. Roli i prefektit është në krijimin e klimës për bashkëpunim dhe pjesëmarrje të qytetarëve. Shpëtimi nuk është në atë që të punojë qeveria dhe komunat, por të punojnë qytetarët. Aty qëndron edhe shkaku për zmadhimin e papunësisë. Kryetarët e komunave nuk dëshirojnë që ta imponojnë agjendën ekonomike mbi atë politike dhe fokusohen në shpërndarjet nga buxheti, për dhënien e ndihmave ose për ndërtimin e objekteve. I vogël është numri i prefekteve që paralajmëronin ndryshime për të cilat duhet krenari. Ndryshimet nuk është e domosdoshme të jenë vetëm pozitive: për të arrihet deri tek yjet, shkohet nëpër ferra. Por si kjo tu thuhet qytetarëve dhe të mbetet në pushtet? Liderët e vërtet i tregojnë edhe punët e mira edhe të këqijat, ndërsa liderët tanë tregojnë vetëm – të mirat.

Nuk duhet ta ndryshojmë qiellin por shpirtin
Ndërtimi i objekteve nuk është ndryshim! Ndryshimet medoemos të jenë në shprehite tona, diturit, veprimet. Sipas projektit te UE (Projekti është ndryshim) duhet të theksohet qartë: çfarë do të ndodhë me një kategori të caktuar qytetarësh, a do të punësohen ato, a do të trajnohen për shanse më të mëdha për punësim, a do të jenë të kyçur në aspekt social në jetën ekonomike dhe shoqërore të komunës? Ky është shkaku përse pak projekte dorëzohen deri te fondet evropiane: hiket nga përgjegjësia që të bëhen ndryshime dhe nga notimi publik i asaj që është bërë. Në vend të saj, ne lavdërohemi.

Ata që harxhojnë para orientohen kah programet e atyre që japin para

Donatorët e UE financojnë që të realizojnë ndonjë politikë të definuar, e cila gjithmonë bazohet në mendimin e qëndrimit të qytetarëve dhe në zhvillimin e liderizmit që të sigurohen ndryshimet e tilla. Për neve të nevojshme janë vetëm treguesit formal: sa është ndërtuar, ku, sa ka kushtuar..... në vend të asaj kandidatët për prefekt flasin vetëm për buxhetin e komunës, shtetit, ndërsa në kohën e fundit edhe për detyrime për bukë dhe lojë.

Jo seriozisht me programet



Ndryshimin mund ta bëjnë vetëm ato që janë vetë të ndryshuar

Kush janë ato njerëz që do t'i realizojnë projektet (ndryshimet)? Tek ne lojalitetit (dëgjueshmërisë) i jepet rëndësi të tepërt për dallim nga kompetencat. Nuk është mirë edhe në rast se kemi 90% kompetenca e të mos kemi lojalitet. Ai është problemi i ekspertëve nga UE ku mungon lojaliteti, po qe se s'ka sukses të madh në projektet e realizuara. Kompetenca nuk është në arsimimin, por në diturinë dhe përgjegjësinë të garantohet të arriturat e vet projektit.

Asociacioni për tolerancë qytetare dhe bashkëpunim (AGTIS)

Ne punojmë në lëmi të demokracisë bazike, sundimin e drejtësisë dhe akumulimin e forcës politike, parime të subsidiaritetit, vendosja e ekonomisë liberale, zvogëlimin e fuqisë së shtetit ndaj qytetarëve, ndërsa misionin e realizojmë nëpërmjet punës në politikë. Metodave kryesore të cilat i përdorim që të realizojmë ndikim janë: demistifikimi, arti i angazhuar (filme, performancat aktruese në TV, shpërndarje e medie) Më e rëndësishme për është që ta përmirësojmë nivelin e përgjithshëm të demokracisë dhe të rikthejmë politikanët dhe institucionet të akumulojnë veprime të sundimit të keq. E gjithë këtë e ka më gjerësisht në www.agtis.org.mk